VENDIM
Nr. 958, datë 25.11.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "SHTIMI I SIPËRFAQES SË VARREZAVE PUBLIKE NË QYTETIN E VLORËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", të ndryshuar, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Shtimi i sipërfaqes së varrezave publike në qytetin e Vlorës".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "tokë bujqësore" dhe "ullishte", me një vlerë të përgjithshme prej 2 753 800 (dy milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind) lekësh.

4. Vlera totale e shpronësimit, prej 2 753 800 (dy milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhen këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Vlorë.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR PROJEKTIN
"SHTIMI I SIPËRFAQES SË VARREZAVE PUBLIKE TË QYTETIT TË VLORËS"

Për pasuritë e llojit tokë bujqësore (ullishte)

Nr.	Emër e mbiemër	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Lloji i pronës	Sipërfaqe m²	Çmimi lekë për m²	Vlera	Konfirmimet me AMTP	Adresa e pronarit	Shënime
1	Agush Avdullai	1060	76/13	ullishte	4540	281	1,275,740	nr. 15526	Babicë e Madhe	Saktësim dokumentacioni
2	Skender Rrapi	1060	76/11	ullishte	3500	281	983,500	nr. 15527	Babicë e Madhe	Saktësim dokumentacioni
3	Lirim Hania	1060	76/13	ullishte	1760	281	494,560	nr. 15522	Babicë e Madhe	Saktësim dokumentacioni
	SHUMA						**2,753,800**			

Shënim

Lista e pronarëve që do të shpronësohen është plotësuar nga komisioni i vlerësimit, Bashkia Vlorë.

Meqenëse konfirmimi i pronave nuk është dhënë nga ZVRPP-ja Vlorë, por nga AMTP-ja, Komisioni i Posaçëm, i Shpronësimeve në MZHU, vendosi që në tabelë të shënohet, saktësim dokumentacioni.

Për llojin e pronës ullishte, çmimi është 281 lekë/m².